

## FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E ENJTE 24 MARS 2022

Debati i sotëm është nga më të rëndësishmit e kësaj salle, sepse shkon te çdo familje shqiptare. Çdo shqiptar, brenda apo jashtë kësaj salle, e nis ditën e vet me një sërë vendimesh ekonomike në shërbim të familjes së vet, dhe këto vendime drejtohen nga çmimet. Për një pjese të shqiptareve kjo do të thotë më pak ose më shumë bukë mbi tryezat e familjeve të tyre, për një pjesë të biznesit do të thotë falimentim, mbijetesë apo rritje kapacitetesh. Për shkak të kësaj ndjeshmërie, ky debat merr një rëndësi të posaçme. Ndryshe nga debatet e tjera, ku ne mund të tjerrim retorikë të natyrave të ndryshme, ky i sotmi është fund e krye ekonomik. Ekonomia është shkencë e burimeve të limituara dhe e kostove oportune. Nëse shton diku, do të heqësh nga diku, sepse në ekonomi nuk lejohet t'u vendosësh flatra dëshirave dhe as të tolerosh që  $7 \times 7 = 42$ .

Përpara fillimit të luftës në Ukrainë, e tërë bota, por dhe Shqipëria, bazuar në treguesit ekonomikë dhe të gjitha projeksionet, po shkonte drejt normalizimit të postpandemisë, por fillimi i luftës e tronditi këtë trend. Lufta po bëhet gjithnjë e më shumë një goditje e rëndësishme ekonomike, veçanërisht në tregjet e mallrave përmes ngritjes së çmimeve të naftës, gazit dhe drithit. Kjo krizë e re i gjen vendet e ndryshme me ngarkesa të ndryshme të buxhetit të shtetit dhe modele të ndryshme ekonomike. Rrjedhimisht, retorikat populiste, që sjellin shembuj të copëtuar nga këtu e atje, nuk mund të jenë domosdoshmërisht domethënëse për Shqipërinë. Nëse ato nuk marrin parasysh profilin ekonomik e fiskal të vendit, do të mund të ishin të dëmshme nëse do të kopjoheshin pa kriter, sidomos kur kohëzgjatja dhe madhësia e krizës mbeten akoma të paqarta. Natyrisht, një mbështetje fiskale e mirëdizenjuar dhe e mirëtargetuar mund ta reduktojë impaktin negativ në rritje dhe ta mbajë inflacionin në nivele të ulëta. Qeveria është duke bërë pikërisht këtë gjë.

Dihet se në vendet me të ardhura të ulëta, familjet shpenzojnë përqindjen më të lartë të të ardhurave në energji dhe ushqime. Kjo natyrë e buxheteve familjare e bën më të prekshëm familjen shqiptare nga kjo lloj krize, e cila ka goditur pikërisht këto grupe mallrash, të cilat ne importojmë sot më së shumti. Këtë e ka kuptuar mirë qeveria shqiptare, prandaj ajo po vijon ta zbusë efektin e rritjes së çmimit të energjisë në buxhetet e familjeve me të ardhura të ulëta. Kjo është detyrë për sot, por nuk mbaron këtu. Qeveria është angazhuar që, krahas zbutjes së efektit të çmimeve në ngritje të energjisë, të përshpejtojë projektet investuese tashmë të planifikuara, për të diversifikuar burimet e energjisë, si dhe për të përmirësuar kudo ku që të mundet eficiencën e përdorimit të saj. Natyrisht, kjo nuk mund të behet në afat të shkurtër, por do të fillojë në afat të shkurtër, prandaj ajo është tashmë në listën e angazhimeve të qeverisë. U aktivizuan disa instrumente fiskale gjatë pandemisë për të mbrojtur segmentet më të prekura të ekonomisë, por instrumente të tjera janë aktivizuar tashmë prej ditëve të para të reflektimit të krizës në çmime.

Një krizë e tillë nuk pritej dhe as ka precedentë në histori, pas Luftës së Dytë Botërore, ndaj nuk mund të pretendosh që paketat të aktivizohen brenda natës dhe të jenë të drejta, perfekte e shteruese. Çdo ndërhyrje në çmimet e tregut të lirë është deformim. Por ky deformim mund të justifikohet me

përfitimet prej saj në një situatë të pazakontë, siç është koha e pazakonte që po jetojmë. Të thuash retorika mbi problemet e trashëguara prej tridhjetë vjetësh, që u takojnë strategjive afatgjata, të hartuara tashmë nga qeveria, por që nuk mund të zgjidhen të gjitha njëherësh as për një e as për tetë vjet, është të bësh thjesht politikë të dëmshme, por jo ekonomi, ndërkohë që sot, më shumë se kurrë, fjalën e ka dhe duhet ta ketë ekonomia. Faleminderit!